

# Statuti dhe Akti i Themelimit

## I Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar

### " Metushi Invest shpk "

Sot ne Tirane. Data 05. 01. 2022 , Ortaku I Vetem I Shoqerise, "Metushi Invest shpk", **Z.Ani Metushi**, mbajtes i dokumentit te identifikimit me Nr. 036895543 dhe Nr.Personal J40516100W, I thirrur dhe I mbledhur rregullisht ne Seline e Shoqerise me adrese: Rruga Teodor Keko. Unaza e Re, Yzberisht, Tirane, ne mbledhjen e Asamblese se Pergjithshme, Nr 1, Date 05.01.2022 vendosi Themelimin dhe Statutin e shoqerise.

#### Kreu I

**Emertimi i shoqerise, forma Juridike, Selia, Objekti, Kohezgjatja.**

#### **Neni 1**

##### **Emertimi**

Shoqeria me Pergjegjesi te Kufizuar do te emertohet " **Metushi Invest shpk** " .

#### **Neni 2 Forma**

##### **Juridike**

Shoqeria " **Metushi Invest shpk** ", do te jete Person Juridik, sipas percaktimeve dhe dispozitave ligjore te parashikuara ne Ligjin Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Pgr Tregtaret dhe Shoqerite tregtare";

Shoqeria, eshte pergjegjese ndaj te treteve per detyrimet dhe demet e shkaktuara gjate aktivitetit te saj.

Shoqeria " **Metushi Invest shpk** ", eshte shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, kapitali i saj eshte i ndare ne kuota, ku ortaket e saj mbajne pergjegjesi per humbjen deri ne kufirin e vleres se kontributit qe ata kane investuar ne kapitalin themeltar te shoqerise.

#### **Neni 3**

##### **Selia**

Selia e Shoqerise e cila do te jete ne adresen: "Rruga Teodor Keko, Unaza e Re, Yzberisht, Tiranë, Sipërfaqe Ndërtimore 40 m2, Kati Përdhe."

Shoqeria mund te hape ne funksion te aktivitetit te saj.tregetar dhe adresa te tjera sekondare, dhe eshte pergjegjese per te njoftuar cdo ndryshim ne Qendren Kombetare te Biznesit.

#### **Neni 4**

##### **Objekti**

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne fushen e:

- Tabachino. Tregti me pakice e produkteve te duhanit dhe te tjera te ngjashme, produkte ushqimore, pije freskuese, dhe pije alkolike.Take and Go dhe Sherbim Delivery 24-ore.



- Sherbime pagesash te ndryshme, fatura dhe te tjera.
- Veprimtari e agjentit komisioner. Veprimtari e agjentit per sherbimin e pagesave per te tretet, ne emer dhe per llogari te nje subjekti financiar, jo banke. Ushtrim i veprimtarise se transfertave te parave ne emer dhe per llogari te subjektit financiar, jo banke. Kembim valutor.

### **Neni 5 Kohezgjatja**

Shoqeria “**Metushi Invest shpk**” do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje periudhe te pakufizuar kohore duke filluar nga data e regjistrimit te saj ne Qendren Kombetere te Biznesit.

### **Kreu II Kapitali**

#### **Neni 6 Kapitali themeltar**

Kapitali themeltar i shoqerise do te jete **100 lek.**

Kapitali themeltar do te perbehet nga total **1 kuote,** me vlere nominale **100 lek.**

Ortaku i vetem i shoqerise “**Metushi Invest shpk**”, zoteron 100% te Kapitalit Themeltar te Shoqerise, saktesisht 1 kuote me vlere nominale 100 lek.

Pjeset e kapitalit themeltar nuk mund te perfaqesohen nga letra me vlere te tregetueshme. Kontributi i ortakeve mund te jete ne vlere ose ne natyre (pasuri te luajtshme / te paluajtshme, apo te drejta).

#### **Neni 7 Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit**

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nenshkrimeve te Kapitalit Themeltar per kontributet ne para dhe me ane te kontributeve ne natyre, kjo nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e nje eksperti te autorizuar, apo nje eksperti te pavarur, te autorizuar, te nenkontraktuar nga shoqeria per te vleresuar keto kontribute, me kerkese te administratorit te shoqerise apo Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve.

Ne asnje rast shumica nuk mund te detyroje nje Ortak per te rritur angazhimin e tij ne Kapitalin Themeltar te Shoqerise.

Zvogelimi i kapitalit mund te autorizohet nga Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve, e cila e merr kete vendim ne te njejtat kushte te parashikuara edhe per ndryshimin e Statutit te Shoqerise.

Ne te gjitha rastet edhe zvogelimi i kapitalit i prek ortaket ne te njejtën mase ndaj pjeseve te kapitalit qe perfaqesojne.



Projekti i zvogelimit te kapitalit u komunikohet eksperteve kontabel te autorizuar, ne rast se ka te tille, te pakten 45 dite perpara dates se percaktuar te Asamblese te thirrur per te marre vendim rreth keti projekti.

### **Neni 8** **Transferimi i kapitalit**

Kuotat e kapitalit te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar e te drejttat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen nepermjet:

1. Kontributit ne kapitalin e shoqerise ;
2. Shit-blerjes;
3. Trashgimise;
4. Dhurimit;
5. Cdo menyre tjeter te parashikuar me ligj;

Ne rastin e kalimit te kuotave me kontrate, kontrata duhet te behet me shkrim. Personi qe kalon kuoten dhe ai qe e fiton ate pergjigjen ne menyre solitare ndaj shoqerise per detyrimet qe rrjedhin nga zoterimi i kuotes, nga casti i kalimit te kuotave deri ne castin e regjistrimit te kalimit te saj ne Qendren Kombetare te Regjistrimit, sipas nenit 43 te ligjit nr.9723, dt. 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit".

Regjistrimi i kalimit te kuotave ka efekt deklarativ.

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ndermjet ortakeve.

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme me rruge trashegimie.

### **Kreu III** **Organet Vendimarrse dhe Drejtuese**

#### **Neni 9** **Organi vendimarrs**

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimarrs i shoqerise.

Asambleja e Ortakeve miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara me ligj.

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per ceshtjet e meposhtme:

- a. Percaktimin e politikave tregtare te shoqerise;
- b. Ndryshimin e statutit;
- c. Emerimin dhe shkarkimin e Administratorit te Shoqerise;
- d. Emerimin dhe shkarkimin e Likujduesve dhe Eksperteve Kontabel te autorizuar;
- e. Percaktimin e shperblimeve per personat ne germenat "c" dhe "d" te kesaj pike;
- f. Mbikqyrjen e zbatimin e politikave tregtare nga administratori, perfshire dhe pregatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- g. Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- h. Zmadhim dhe zvogelim te kapitalit;
- i. Perfaqesim te Shoqerise ne gjykate dhe ne procedime te tjera ndaj administratoreve;
- j. Riorganizim dhe prishje te shoqerise;
- k. Shnderrimin ne nje forme tjeter;
- l. Miratim te rregullave proceduriale te mbledhjeve te Asamblese;
- m. Ceshtje te tjera te parashikuara nga Ligji apo Statuti;



Ortaku mund te perfaqesohet ne Asamblene e Pergjithshme ne baze te nje autorizimi, nga nje ortak tjetër apo nga nje person i trete.

Autorizimi per perfaqesim te ortakut mund te jepet dhe te jete i vlefshem vetem per nje mbledhje te Asamblese se Pergjithshme, e cila perfshin edhe mbledhjet vijuese ne te njejtin rend dite.

Administratori i Shoqerise, nese eshte nje person i trete i ndryshem nga Ortaket e Shoqerise, nuk mund te veproj si perfaqesues i ortakeve ne Asamblene e Pergjithshme.

#### **Neni 10**

#### **Menyra e thirrjes se mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme**

Asambleja e Pergjithshme thirret nepermjet nje njoftimi me shkrim ose nje njoftimi nepermjet postes elektronike nga Administratori i Shoqerise me kerkese te ortakeve.

Njoftimi duhet te permbaje vendin, daten dhe oren e mbledhjes, si dhe rendin e dites, dhe duhet t'u dergohet te gjithe ortakeve, jo me vone se shtate dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e Asamblese se Pergjithshme.

Kur Asambleja e Pergjithshme nuk eshte thirrur sipas percaktimeve sipas ketij neni, ajo mund te marre vendime qe konsiderohen te vlefshme, vetem nese te gjithe ortaket jane dakort per te marre vendime, pavaresisht parregullsisë.

#### **Neni 11**

#### **Kuorumi**

Ne rastin e marrjes se vendimeve qe kerkojne nje shumice te zakonshme, Asambleja e Pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortaket me te drejte vote qe zoterojne me shume se 50 % te kuotave.

Ne rastin kur Asambleja e Pergjithshme duhet te vendos per ceshtje te cilat kerkojne shumice te kualifikuar sipas nenit 87 te ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese ortaket qe zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te votave jane te pranishem personalisht, votojne me shkrese, apo mjete elektronike sipas parashikimeve te pikes 3 te nenit 88 te ketij ligji.

Nese Asambleja e Pergjithshme nuk mund te ngrihet per shkak te mungeses se Kuorunit te permendur me lart, asambleja mbledhet perseri jo me vone se 30 dite, ne te njejtin rend dite.

#### **Neni 12**

#### **Marrja e vendimeve**

Asambleja e Pergjithshme per marrjen e vendimeve te percaktuara ne nenin 9, kreu 3, zhvillon mbledhje te jashtezakonshme te cilat jane te vlefshme kur jane te pranishem ortaket me te drejte vote qe zoterojne me shume se gjysma e numrit total te kuotave.



Cdo ndryshim statuti i shoqerise nga Asambleja e Pergjithshme, i bere konform dispozitave te paracaktuara, duhet te depozitohet prane Qendres Kombetare te Regjistrimit per te pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise

### **Neni 13 Administrimi**

Ne kete mbledhje Asambleje gjithashtu u vendos qe administratori i shoqerise do te jete **Z.Ani Metushi**, mbajtes i dokumentit te identifikimit me **Nr.Personal J40516100W**.

Administratori do te zhvilloj detyren e tij sipas Statutit dhe Ligjit per nje periudhe 5 (pese) - vjecare me te drejte riperteritje, nga data e regjistrimit ne QKB.

Ne vazhdim shoqeria do te administrohet nga nje administrator, qe do te percaktohet me Vendim te Asamblese se Pergjithshme. Asambleja e Pergjithshme mund te shkarkoj Administratorin me nje shumice te zakonshme.

Statuti apo marreveshje te tjera nuk mund ta perjashtojne apo kufizojne kete te drejte.

Administratori mund te shkarkohet nga Gjykata per shkelje te ligjit dhe me kerkese te cdonjerit prej ortakeve.  
Percaktimi i administratorit dhe cdo ndryshim i tij njoftohet per regjistrim prane Qendres Kombetare te Regjistrimit.

Emerimi i Administratorit prodhon efekte pas regjistrimit ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.

Administratori i shoqerise mund te emerohet ortaku i saj ose dhe nje person jashte ortakerise.

### **Neni 14 Kompetencat**

Administratori ka te drejte:

- a. Te kryeje te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise, duke zbatuar politikat tregtare te vendosura nga Asambleja e Pergjithshme;
- b. Te perfaqesoj shoqerine tregtare;
- c. Te kujdeset per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumenteve dhe te librave kontabel te shoqerise;
- d. Supervizon pergatitjen e pasqyrave financiare dhe bilancin vjetor si dhe miraton raportet e ecurise se veprimtarise dhe sebashku me propozimet e shperndarjeve te fitimeve i paraqet kto dokumenta perpara Asamblese se Pergjithshme per miratim;
- e. Krijon nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise;
- f. Kryen regjistrimet dhe dergojne te dhenat e detyrueshme te shoqerise sic parashikohet ne Ligjin per qendren kombetare te regjistrimit;
- g. Kryejne detyra te tjera te percaktuara ne ligj dhe statut;

Administratori eshte i detyruar te therrase Asamblenë e Pergjithshme ne rastet kur:

- a. Me kerkese te secilit nga ortaket e shoqerise;
- b. Per qellim parashtrimin e raporteve financiare bilanceve vjetore si dhe raporteve te tjera objekt miratimi i Asamblese se Pergjithshme;



- c. Ne raste kur ekziston rreziku qe aktivet e shoqerise nuk i mbulojne detyrimet e kerkueshme brenda tre muajve dhe ne vazhdim;
- d. Si dhe detyrimet e tjera te parashikuara nga ligji per tregetaret dhe shoqerite tregetare;

Administratori ka te drejte te kryeje te gjitha veprimet e administrimit te zakonshem. Administratori perfaqeson Shoqerine perpara te gjith personave fizik e juridik, publik dhe/ ose private vendas apo te huaj, autoriteteve shteterore Shqipetare apo te huaja, perfshi ktu autoriteteve gjyqesore te te gjitha shkalleve.

Administratori ka te gjitha kopetencat per te vepruar me marredhenie me te tretet ne emer te Shoqerise, ne te gjitha rrethanat, me perjashtim te kopetencave qe ligi ja jep shprehimisht Ortakeve te Shoqerise.

Administrator angazhon shoqerine ne marredhenie me te tretet nepermjet akteve qe jane ne perputhje me objektin e saj. Shoqeria nuk merr persiper pasojat ndaj te treteve kur ajo provon qe akti i administratorit e kalonte objektin e shoqerise, si dhe kopetencat e administratorit te saj.

### **Neni 15** **Pergjegjesite e Administratorit**

Administratori eshte pergjegjes individualisht ndaj shoqerise ose ndaj te treteve per shkelje te ligjeve, per shkelje te statutit apo per faje te kryera gjate administrimit te Shoqerise. Pasojat e marreveshjeve te pa miratuara nga Asambleja e Pergjithshme sipas dispozitave dhe menyres se miratimit te percaktuara ne kete statut, qe i sjellin dem shoqerise i ngarkohen Administratorit, si dhe ortakut qe ka bere marreveshjen (ne rastet kur), per te perballuar ne menyre individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat perkatese.

Administratori ka barren e proves per te vertetuar kryerjen e detyrave ne menyre te rregullt e sipas standarteve te kerkuara bazuar ne Ligj dhe Statut.

Pervecse eshte parashikuar ne dispozitat e pergjithshme te detyrimit te besnikerise sipas neneve 14,15,17 e 18 te ligjit "Per Tregetaret e Shoqerite tregetare", Administratori detyrohet:

- a. Te kryeje detyrat e percaktuara ne Ligj e ne Statut ne mirebesim e ne interesin me te mire te Shoqerise ne teresi, duke i kushtuar vemndje te vecante ndikimit te veprimtarise se Shoqerise ne mjedis
- b. Te ushtroje kopetencat qe i njihen ne ligj dhe Statut vetem per arritjen e qellimeve te percakuara ne keto dispozita
- c. Te vleresoje me pergjegjesi ceshtjet per te cilat merret vendim
- d. Te parandaloje dhe menjanoje rastet e konfliktit prezent apo te mundshem te interesave personale me ato te shoqerise
- e. Te ushtroje detyrat e tij me profesionalizem dhe kujdesin e nevojshem.

Administratori gjate kryerjes se detyrave te tij pergjigjet ndaj shoqerise per cdo veprim apo mos veprim qe lidhet ne menyre te arsyeshme me qellimet e Shoqerise, me perjashtim te rasteve kur ne baze te hetimit dhe vleresimit te informacioneve perkatese veprimi ose mos veprimi eshte kryer ne mirebesim.



Ortakët individualisht ose së bashku kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit, nëse verëhen shkëlqje me pasoje dëme për shoqërinë. Kanë të drejtë ta ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e dëmit që i është shkaktuar Shoqërisë, përfshirë dhe dëmshpërblim Financiar, nëse është e nevojshme.

Asnjë vendim i Asamblesë së Përgjithshme nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër Administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

#### **Kreu IV** **Viti Financiar, Bilancet dhe Dividentet**

##### **Neni 16** **Viti financiar**

Viti Financiar i Shoqërisë fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor. Përfshirë viti i parë fillon nga data e regjistrimit të Shoqërisë në Qendren Kombëtare të biznesit (QKB) dhe mbyllet më 31 Dhjetor.

##### **Neni 17** **Bilanci i Shoqërisë dhe Dividentet**

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve miraton Bilancin Vjetor e paraqitur nga Administratori.

Mbledhja e ortakëve vendos rreth shpërndarjes së Dividentit pasi të jenë zbritur humbjet e vitit të mëparshëm financiar sic edhe parashikohet nga ligji.

#### **Kreu V** **Shpërndarja ose Likuidimi i Shoqërisë, Bashkimi, Ndarja, Shndërrimi**

##### **Neni 18** **Shpërndarja ose Likuidimi i Shoqërisë**

Shpërndarja ose Likuidimi i shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë:

- a. Kur mbaron kohezgjatja e parashikuar në themelimin e saj
- b. Me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve
- c. Me hapjen e procedurave të falimentimit
- d. Me vendim gjykatë
- e. Cdo formë apo rrethë tjetër e parashikuar nga Ligji

Prishja e Shoqërisë tregëtare ka si pasoje hapjen e procedurave të likuidimit, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedure falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortakët në vendim të Asamblesë së përgjithshme të ortakëve.



Ne rastet kur nuk eshte percaktuar nga ana e ortakeve te Shoqerise nje likuidues, brenda 30 diteve pas prishjes, cdo person i interesuar, mund ti drejtohet gjykates per te caktuar nje Likuidues.

#### **Neni 19**

#### **Te drejtat dhe detyrimet e Likuiduesve**

1. Detyra e Likuiduesve eshte mbyllja e te gjitha veprimeve te Shoqerise, mbledhja e kredive t pa arketuara dhe kontributeve te pashlyera, shitja e pasurive te shoqerise dhe shlyerja e kreditoreve duke respektuar rradhen e referimit sipas nenit 605 te kodit civil.
2. likuiduesi mund te kryeje dhe veprime te reja tregetare per mbylljen e nje veprimi te paperfunduar.
3. Nese ne baze te pretendimeve te ngritura nga Kreditoret, sipas nenit 194 te ligjit "Per Tregetaret dhe Shoqerite tregetare likuiduesit verejne se Shoqerise tregetare, perfshire kontributet e pa shlyera nuk eshte e mjaftueshme per pagesen e ketyre pretendimeve, Likuiduesi detyrohet te pezulloje proceduren e Likuidimit e ti kerkoje Gjykates perkatese nisjen e procedurave te falimentimit.

#### **Neni 20**

#### **Perfundimi i Likuidimit**

Pas Shperndarjes se Aktiveve te mbetura, Likuiduesi e njofton Qendren Kombetare te Regjistrimit per perfundimin e Likuidimit dhe kerkon c' regjistrimin e Shoqerise ne perputhje me Seksioni 5 te ligjit "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit".

#### **Neni 21**

#### **Bashkimi**

Dy ose me shume Shoqeri mund te bashkohen nepermjet:

1. Kalimit te te gjite aktiveve dhe pasive te njeres apo me shume shoqerive qe quhen shoqerite perthithura, te nje shoqeri tjeter egzistuese e quajtur Shoqeria perthithese.
2. Themelimit te nje shoqerie te re, tek e cila kalohen te gjitha aktivet apo pasive e shoqerise egzistuese, qe bashkohen ne kembim te kuotave ne shoqerine e e re.

#### **Neni 22**

#### **Ndarja**

Rastet kur mund te ndahet nje Shoqeri:

1. Nje Shoqeri mund te ndahet me vendim te Asamblese se Ortakeve duke transferuar te gjitha aktivet e pasivet e veta ne favor te dy ose me shume Shoqerive ekzistuese apo te themeluara rishtazi. Shoqeria qe ndahet vleresohet e prishur.
2. Per ndarjen e shoqerise zbatohen perkatesisht dispozitat e neneve 216 deri ne 225 te ligjit 9901 date 14.04.2008
3. Shoqerite qe fitojne pasurite e shoqerise qe ndahet quhen shoqeri pritesa dhe pergjigjen ne menyre solidare per detyrimet e kesaj te fundit.
4. Regjistrimi i ndarjes se shoqerise prane qendres Kombetare te Regjistrimit ka si pasoje:





- a. Kalimini e shoqerise pritesë të të gjitha aktiveve e pasiveve të shoqerise që ndahet në përputhje me raportin e ndarjes të përcaktuar në marrëveshjen e ndarjes. Ky kalim sjell pasojë për marrëdhëniet ndërmjet shoqerive si dhe për palet e treta;
- b. Berjen e aksionereve/ortakeve të shoqerise që ndahet aksionare apo ortakë të një ose më shumë shoqerive pritesë në përputhje me raportin e ndarjes përcaktuar në marrëveshjen e ndarjes;
- c. Vlerësimin e shoqerise që ndahet si e prishur dhe c' regjistrimin e saj në Qendren Kombëtare të Regjistrimit sipas seksionit 5 të ligjit nr 9723 datë 03.05.2007 "për Qendren Kombëtare të Regjistrimit" pa kryerjen e likuidimit.

**Neni 23**  
**Shndërrimi**

Shoqëria mund ta ndryshojë formën e vet ligjore nëpërmjet shndërrimit të saj në shoqëri aksionere.

Kjo nuk sjell pasojë mbi të drejtat dhe detyrimet që shoqëria ka marrë përse për ndaj të treta.

**Kreu VI**

**Mosmarrëveshjet, Baza Ligjore, Dispozita të përgjithshme**

**Neni 24**  
**Mosmarrëveshjet**

Mosmarrëveshjet që mund të lindin, mund të zgjidhen me mirëkuptim, në të kundërt kompetente do të jetë Gjykata e Shkallës së parë Tirane.

**Neni 25**  
**Baza ligjore**

1. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
2. Ligji Nr 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregëtare";
3. Ligji Nr. 9723 datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
4. Kodi Civil;
5. Ligji Nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", I Ndryshuar;
6. Ligji nr. 8449, datë 27.01.1999 "Kodi Doganor", I Ndryshuar;

**Neni 26**  
**Dispozita të përgjithshme**

Ky statut u përpilua në 2 (Dy) kopje me përmbajtje dhe vlerë të njëjta juridike, u miratua nën për Nen nga Ortaku Themelues të Shoqërisë Tregëtare "Metushi Invest shpk"

**Ortaku I Vetëm I Shoqërisë**  
**"Metushi Invest shpk"**  
**Z. Ani Metushi**

Ani Metushi 